



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:107779

Datë: 14.03.2025

Numri i dokumentit: 06991747

PKR.nr.301/2006

NË EMËR TË POPULLIT

- GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari Fatos Sejdiqaj, me anëtarët e trupit gjykues-Gjyqtarët : Mentor Hajraj dhe Xhemajl Jusufi, bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Tahiri dhe zyrtaren ligjore Atdhetare Bashota-Krasniqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit : A.H., për shkak të veprave penale në ndihmë nga pika III : Vrasje nga neni 30 al.1 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (më tej:LPK-së) dhe Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (më tej:LPK-së), lidhur me nenin 19 dhe nenin 24 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (më tej:LPJ-së) dhe për veprën penale nga pika IV-Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (më tej:LPK-së), lidhur me nenin 19 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (më tej:LPJ-së), akuzuar sipas aktakuzës së ish-Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Krimeve të Rënda në Mitrovicë PP.209/1 datë 21.08.2002, rikualifikuar për pikën III nga Prokurorja e shtetit në shqyrtimin gjyqësor të datës 04.02.2025, në veprat penale në ndihmë-Vrasje në çast nga neni 33 i Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (më tej:LPK-së) e lidhur me nenin 24 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (më tej:LPJ-së) dhe Vrasje në çast në tentativë nga neni 33 të LPK-së e lidhur me nenin 19 dhe nenin 24 të LPJ-së, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik me datë 04.02.2025 në të cilin prezent ishin Prokurorja e shtetit Fetije Bajrami, i akuzuari A.H. si dhe Mbrojtësi i tij Av.A. Tahiri, me datë 07.02.2025 ka shpallur publikisht, ndërsa më datën 14.03.2025 e përpiloi me shkrim këtë :

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit:

A.H., nga i ati, e ëma, i vajzërisë lindur me datë në Mitrovicë, tani me vendbanim në Prishtinë, rruga “.....” pn, me numër personal, shqiptar, shtetas i

Republikës së Kosovës, mastër i shkencave ekonomike, i martuar, baba i katër fëmijëve, i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike.

I

Për pikën III të aktakuzës

- Në bazë të nenit 362 paragrafi 1, nënpar.1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje:KPP) :

REFUZOHET AKUZA

- **SEPSE** : Me datën 02.06.1998 rreth orës 18:10 minuta, në vendin e ashtuquajtur “.....” në fshatin, komuna e Mitrovicës, me dashje i ka ndihmuar të akuzuarit Sh. në kryerjen e veprës penale të vrasjes ndaj tani të ndjerit A.B. dhe vrasjes në tentativë ndaj të dëmtuarit , në atë mënyrë që në kërkesë të akuzuarit Sh., ka shkuar në shtëpinë e tyre në afërsi të vendit të ngjarjes, ka marrë dhe repetuar revolen nën pikën I të cilën ia ka sjell të akuzuarit Sh. me qëllim që ky ta përdor më shpejtë dhe më lehtë.

- **Me këtë kishte për të kryer veprat penale në ndihmë-Vrasje në çast nga neni 33 i LPK-së e lidhur me nenin 24 të LPJ-së dhe Vrasje në çast në tentativë nga neni 33 të LPK-së e lidhur me nenin 19 dhe nenin 24 të LPJ-së.**

- Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

- Pala e dëmtuar E.B. nga fshati-Komuna Mitrovicë, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

II

Për pikën IV të aktakuzës

ËSHTË FAJTOR

- **SEPSE** : Në të njëjtin vend dhe kohë si nën pikën III me dashje ka filluar kryerjen e veprës penale të vrasjes ndaj të dëmtuarit R.B.por, e njëjta ka mbetë e papërfunduar sepse ka menduar se me goditjen e dhënë ka arritur qëllimin e vrasjes, në atë mënyrë që ka marr kosën me të cilën më parë kosiste i dëmtuari dhe me tehun e saj njëherë e godet në anën e majtë të regjionit të shpinës, në momentet gjersa i dëmtuari tentonte të përkujdesej rreth tani të ndjerit, duke i shkaktuar plagë prerëse e cila është e natyrës së rëndë trupore, shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit prerës.

- Me këtë ka kryer veprën penale - Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së e lidhur me nenin 19 të LPJ-së.

- Andaj, Gjykata në mbështetje të nenit 30 të LPK-së, nenin 1, 2, 3, 4, 5, 8, 11, 13, 19, 31, 32, 33, 34, 35, 38, 42, 43 të LPJ-së, e lidhur me nenin 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, të akuzuarin e :

- G J Y K O N -

I.- Me Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë. Të akuzuarit në bazë të nenit 50 të LPJ-së në dënimin e caktuar i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 06.08.2002 deri me datën 31.03.2003.

II.- Obligohet i akuzuari që t`i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50.00 € (njëzetë euro), si dhe në emër të taksës së kompensimit të viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50.00) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas që aktgjykimi të merrë formën e prerë.

III.- Pala e dëmtuar R.B. me adresë vendbanimi në fsh.....-Komuna Mitrovicë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

- Rrjedha e çështjes –

Ish-Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP.209/1 datë 21.08.2002 ndaj të akuzuarit Sh. H. për shkak të veprave penale I. Vrasje nga neni 30 al.1 të LPK-së, dhe II. Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së lidhur me nenin 19 të LPJ-së në bashkim real me veprën penale nën pikën I e të ndëshkuar sipas nenit 30 al.3 të LPK-së, ndërsa i akuzuari A.H. për shkak të veprës penale III. Vrasje nga neni 30 al.1 të LPK-së dhe vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së, lidhur me nenin 19 të LPJ-së lidhur me nenin 24 të LPJ-së, si dhe IV. Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së lidhur me nenin 19 të LPJ-së në bashkim real me veprat e përshkuara nën pikën III lidhur me nenin 24 dhe 19 të LPJ-së.

- Me Aktgjykimin e ish-Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P.nr.72/02 datë 31.03.2003, i akuzuari Sh. H. është shpallur fajtor për veprën penale-Vrasje në tejkallim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 30 al.1 të LPK-së, lidhur me nenin 9 al.3 të LPJ-së dhe veprën penale Vrasje në tentativë në tejkallim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 30 al.1 të LPK-së lidhur me nenin 19 dhe 9 al.3 të LPJ-së në bashkim real me veprën penale si në pikën 1 e të dënueshme sipas nenit 30 al.3 të LPK-së, dhe e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) viteve në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha

e kaluar në masën e paraburgimit. Ndërsa të akuzuarin A.H., e ka liruar nga akuza për veprën penale për pikën III-Vrasje nga neni 30 al.1 të LPK-së dhe Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së lidhur me nenin 19 të LPJ-së lidhur me nenin 24 të LPJ-së si dhe për veprën penale për pikën IV-Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së lidhur me nenin 19 të LPJ-së në bashkim real me veprat e përshkruara nën pikën III e të gjitha të ndëshkuara sipas nenit 30 al.3 të LPK-së lidhur me nenin 19 e 24 të LPJ-së.

- Me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.nr.259/2003 të datës 20.11.2003, është aprovuar ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në Mitrovicë dhe aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P.nr.72/2002 të datës 31.03.2003 e ka prishur dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim në të njëjtën gjykatë.

- Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, ka shqyrtuar çështjen në rigjykim ashtu që, me Aktgjykimin P.nr.15/2004 të datës 04.04.2005, përsëru të akuzuarin Sh. H. e ka shpallur fajtor për veprën penale Vrasje në tejkallim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 30 al.1 të LPK-së, lidhur me nenin 9 al.3 të LPJ-së dhe veprën penale Vrasje në tentativë në tejkallim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 30 al.1 të LPK-së lidhur me nenin 19 dhe 9 al.3 të LPJ-së në bashkim real me veprën penale si në pikën 1 e të dënueshme sipas nenit 30 al.3 të LPK-së, dhe e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) viteve në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit. Ndërsa të akuzuarin A.H., e ka liruar nga akuza për veprën penale Vrasje nga neni 30 al.1 të LPK-së dhe Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së lidhur me nenin 19 të LPJ-së lidhur me nenin 24 të LPJ-së si dhe për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së lidhur me nenin 19 të LPJ-së në bashkim real me veprat e përshkruara nën pikën III e të gjitha të ndëshkuara sipas nenit 30 al.3 të LPK-së lidhur me nenin 19 e 24 të LPJ-së.

- Tani, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin e saj Ap.nr.325/2005 datë 15.06.2006, ka miratuar pjesërisht ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Mitrovicë dhe e ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P.nr.15/2004 të datës 04.04.2005 sa i përket të akuzuarit Sh. H. vetëm përkitazi me cilësimin juridik dhe vendimit për dënim ashtu që, ka konstatuar se në veprimet inkriminuese të përshkruara në pikën I/1 të akuzuarit Sh. H. ka gjetur se përmbushen tiparet e veprës penale të-Vrasjes në çast nga neni 33 të LPK-së, dhe pikën I/2 përmbushen elementet e veprës penale të Vrasjes në tentativë në çast nga neni 30 al.1 të LPK-së, dhe për këto vepra i ka caktuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej shtatë (7) viteve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim. Ndërsa, për pikën III dhe IV të dispozitivit të aktakuzës sa i përket të akuzuarit A.H. ka anuluar aktgjykimin e kësaj gjykate dhe çështjen ia ka kthyer të njëjtës në rigjykim.

Gjykata e shkallës së parë ka vepruar sipas vërejtjeve të dhëna në aktvendimin e sipërtheksuar të Gjykatës Supreme të Kosovës ashtu që, në rigjykim nuk administroi prova të reja, nga se nuk kishte

08/101:15102

propozime nga palët subjekte në procedurë penale për një gjë të tillë, por edhe sipas detyrës zyrtare gjykata ka vlerësuar se nuk është nevojshme nxjerrja e provave të reja për këtë çështje penale dhe në rigjykim vetëm i vlerësoi provat ekzistuese, përkitazi me të akuzuarin A.H..

- Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale me datë 27.11.2024 dhe datë 21.01.2025, në të cilat prezent kanë qenë Prokurori i shtetit i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda-Fetije Bajrami, i akuzuari A.H. si dhe mbrojtësi i tij Av.A. Tahiri, i dëmtuari E.B. si dhe Mbrojtësi i viktimave Muhamet Pervetica.

- Duke qenë se në këtë çështje penale shqyrtimi gjyqësor kishte zgjatur me tepër se gjashtë (6) muaj si dhe ka ndryshuar përbërja e trupit gjykues, Gjykata në mbështetje të nenit 307 par.1 dhe par.3 të KPP-së, shqyrtimi gjyqësor filloj rishtas ngase është fakt i ditur që gjyqtari i ngarkuar me këtë lëndë kishte dhënë dorëheqje dhe Gjykata përsëri i ka administruar të gjitha provat.

- Gjykata të akuzuarin e ka njoftuar me të drejtat e tij procedurale nga neni 319 par.2 të KPP-së. I akuzuari A.H. ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij procedurale ndërsa, sa i përket mbrojtjes deklaroi se ka angazhuar mbrojtësin Av.A. Tahiri.

- Fjala përfundimtare e palëve –

- *Prokurorja e shtetit Fetije Bajrami*, në fjalën përfundimtare fillimisht bëri ri cilësimin ligjor sa i përket veprës penale si në pikën III të dispozitivit të aktakuzës duke e ri kualifikuar në veprën penale ndihmë në- Vrasje në çast nga neni 33 të LPK-së lidhur me nenin 24 të LPJ-së dhe Vrasje në tentativë në çast nga neni 33 të LPK-së, lidhur me nenin 19 dhe 24 të LPJ-së, për shkak se kjo pikë e dispozitivit të aktakuzës lidhet me pikën I dhe II të dispozitivit të aktakuzës e për të cilën me aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap.nr.325/2005 të datës 15.06.2006 sipas detyrës zyrtare janë ri kualifikuar këto vepra penale, ndërsa sa i përket pikës IV ka theksuar se duhet të jetë Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së e lidhur me nenin 19 të LPJ-së. Në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, mes tjerave theksoj se, mbetet në tërësi pranë aktakuzës së ri kualifikuar për pikën III të aktakuzës të ngritur ndaj të akuzuarit A.H. ndërsa pika IV mbetet e pandryshuar. Tutje, në fjalën përfundimtare ka theksuar se me nxjerrjen e provave gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprat si më lartë. Sipas prokurorisë i akuzuari Sh. kërkon nga i akuzuari A. që t'ia sjell revolen, i akuzuari A. shkon me vrap në shtëpi merr revolen familjare, së pari e raportit e pastaj ia jep të akuzuarit Sh. i cili nga distanca 2-3 metra shtinë në tani të ndjerin A. duke e goditur 4 herë për çka i njëjti vdes në vendin e ngjarjes, pastaj kthehet kah i akuzuari E. në të cilin shtënë tri herë dhe pastaj E.i rrëzohet dhe mbetet i shtrirë për tokë. I dëmtuari R. i afrohet babait të vet në atë moment të lënduar që ta shpëtoj jetën dhe

gjersa gjendej i kërrusur përmbi të, i akuzuari A. e godet në shpinë me teh të kosës dhe i shkakton lëndime të rënda trupore. Sa i përket veprës penale si në pikë III dhe IV të dispozitivit vërtetohet nga dëshmitë e dëshmitarëve E.B., A1. B., B.B.. Sa i përket pikës III i akuzuari A. e mohon në tërësi veprën penale duke thënë se në momentin kritik nuk ka qenë fare në vendin e ngjarjes, kjo sipas prokurorisë është e orientuar në shmangien nga përgjegjësia penale. Gjithashtu i njëjti mohon edhe veprën penale si në pikën IV me qëllim që ti shmanget përgjegjësisë penale por kryerja e kësaj vepre vërtetohet gjithashtu edhe nga dëshmitarët R., E., A1. dhe D. të cilët e vërtetojnë faktin se i njëjti me tehun e kosës e ka goditur në shpinë të dëmtuarin R.B. me qëllim që ta privoj nga jeta. Dëshmitarja A1. B. ka deklaruar se në vendin e ngjarjes kanë qenë Sh.i, A.i dhe Xh., ku sipas saj Sh.i ka kërkuar nga A.i që t'ia sjell revolen nga shtëpia, i njëjti ka shkuar e ka marr revolën dhe është kthyer. Dëshmitari B.B. ka deklaruar se edhe i akuzuari A. ka qenë në vendin e ngjarjes. Dëshmitari R. ka deklaruar se Sh.i, A.i dhe Xh. kanë ardhur dhe se Sh.i ka kërkuar nga A.i që të shkoj në shtëpi dhe i njëjti është kthyer me revole në dorë, sipas tij A.i e godiste me shkelma të ndjerin A.n dhe shante, ka shtuar se e ka parë A.in duke hyrë në shtëpi dhe se i njëjti ka marr diçka dhe pas disa minutash ka dëgjuar disa të shtëna. I dëmtuari R.B. ka deklaruar se A.in e ka parë me kosë në dorë me të cilën e ka goditur një herë në shpinë dhe gjithashtu shton se të njëjtin e ka parë me revole në dorë. Gjithashtu edhe dëshmitari E.B. ka deklaruar se atë ditë babai i ndjerë është shtyrë me Sh. H. ashtu që shtynin njëri tjetrin me dorë dhe ka ardh djali tjetër i Sh.it, A.i me revole në dorë e të cilën revole ia mori Sh.i e me të cilën edhe ka shtënë. Nga të gjitha këto i ka propozuar gjykatës që me rastin e caktimit të llojit të vendimit të merr parasysh rrethanat rënduese, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e kryesit të veprës penale, dashjen e tij për ta kryer veprën penale me ç' rast ka humbur jetën i ndjeri A.B. e po ashtu edhe një i dëmtuar ka pësuar lëndime trupore, ndërsa si rrethanë lehtësuese të marr parasysh kohën e gjatë nga kryerja e veprës penale, e në bazë të gjitha këtyre provave i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

- *Mbrojtësi i viktimave Muhamet Pervetica*, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim mes tjerave theksoj se, nga provat e administruara është vërtetuar se i akuzuari ka kryer dhe është përgjegjës për veprën penale për të cilën akuzohet, sipas tij në këtë çështje janë arritur të vërtetohen faktet kontestuese dhe relevante, Gjykata arriti që mbi bazën e dëshmisë së të dëmtuarit-dëshmitarit E.B. të vërtetoi se i akuzuari ishte prezent në vendin e ngjarjes në momentin kritik dhe se ka ndërmarr veprimet e përshkruara në dispozitiv të aktakuzës me qëllim të privimit nga jeta të të dëmtuarit E.B.. Nga dëshmitë e dëshmitarëve është vërtetuar se shtëpia e të akuzuarit nga vendi i ngjarjes është në largësi 150-160 metra, distancë kjo e cila e bën të besueshme se i akuzuari ka ndërmarr lëvizjen dhe veprimet si të përshkruara nga dëshmitaret dhe atë brenda kohës derisa ngjarja po zhvillohej dhe me qëllim të ofrimit të ndihmës në kryerjen e veprës penale. Në këtë çështje ka theksuar se paraqesim kërkesën pasurore juridike në emër të dëmtuarit E.B. dhe i ka propozuar gjykatës që me rastin e vendosjes, të vendos për

dëmin material dhe jo material të shkaktuar tek i dëmtuari dhe të gjykoj shumat për kompensim sipas praktikës së kësaj gjykate për rastet e tilla. I ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

- *Mbrojtësi i të akuzuarit A.H., av.A. Tahiri*, po ashtu në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim mes tjerave theksoj se, në këtë proces është vërtetuar se akuza e Prokurorisë nuk është e bazuar në fakte dhe prova të cilat do të inkriminonin të mbrojturin tim për veprën penale për të cilën akuzohet, ka konsideruar se provat që i janë bashkangjitur aktakuzës janë në kundërshtim të plot me pretendimet e prokurorisë, sipas tij duke u mbështetur në provat e administruara nuk është vërtetuar teza e akuzes dhe besueshmëria e saj, është vërtetuar se aktakuza është e paqëndrueshme sikurse në aspektin formal ashtu edhe në atë material për faktin se nuk janë plotësuar kushtet e parapara me dispozitat ligjore pasi nuk janë prezantuar prova bindëse që e vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Një konstatim i tillë mbështetet edhe në deklaratën e të mbrojturit të tij A.H. dhe dëshmitë e dëshmitarëve F.B. dhe B.B.. Dëshmitari F.B. mohon ta ketë parë të pandehurin në vendin e ngjarjes, gjithashtu edhe dëshmitari B.B. ka mohuar se e ka parë të pandehurin ditën kritike në vendin e ngjarjes por sipas këtij dëshmitari me të akuzuarin Sh. ka qenë djali tjetër Xh.. Sipas mbrojtjes, nëse i analizojmë këto deklarata veç e veç atëherë vërtetohet se i mbrojturi i tij nuk ka qenë fare prezent ditën kritike në vendin e ngjarjes. Sipas mbrojtjes, dispozitivi i aktakuzës është i paqartë dhe kundërthënës në vetvete për faktin se në raport me të mbrojturin e tij konsideron se i mungojnë elementet qenësore të veprës penale të pretenduar në aktakuzë. Mbrojtja konsideron se prokuroria ka vepruar në mënyrë të padrejtë dhe atë duke pasur parasysh edhe dispozitën ligjore nga neni 48 i KPP-së. Krejt në fund, mbrojtja konsideron se prokuroria të gjitha pretendimet e saj i ka mbështetur në hamendje dhe indicje të cilat janë të pa qëndrueshme dhe të pa vërtetuara, andaj konsideron se fakti se nuk ekziston as edhe një veprim i vetëm inkriminues i të mbrojturit të tij rrjedhimisht nuk është provuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet andaj i ka propozuar gjykatës që ndaj të njëjtit të shpall aktgjykim lirues.

- *I akuzuari A.H.* ka deklaruar se e mbështetë fjalën përfundimtare të paraqitur nga mbrojtësi i tij, dhe se nuk ka asgjë për të shtuar.

- Provat e administruara –

- Gjykata, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka dëgjuar dëshmitaret e propozuar në aktakuzë E.B., Xh.H., ndërsa me pëlqimin e palëve dhe në kuptim të nenit 307 par.1 dhe par.3, lidhur me nenin 335 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.3 të KPP-së, janë lexuar deklaratat e dëshmitarit-të dëmtuarit R.B. dhënë në procesverbalin e gjyqtarit hetues Hep.nr.186/2001 me datë 14.08.2002, në procesverbalet e shqyrtimit kryesor të datës 06.01.2003 dhe

të datës 28.06.2004, deklarata e dëshmitares A1. B. e dhënë në procesverbalin te gjyqtari hetues Hep.nr.186/2001 me datë 13.08.2002 si dhe në procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 28.01.2003, deklarata e dëshmitarit B.B. e dhënë në procesverbalin te gjyqtari hetues Hep.nr.186/2001 me datë 13.08.2002 si dhe procesverbalet e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 29.01.2003 dhe 17.02.2003, deklarata e dëshmitarit F.B. e dhënë në procesverbalin te gjyqtari hetues Hep.nr.186/2001 me datë 14.08.2002 si dhe në procesverbalet e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 06.01.2003 dhe datë 14.09.2021, deklarata e Dr.Faik Bllata e dhënë në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 29.01.2003, deklarata e ekspertit mjeko ligjor Dr.Flamur Blakaj e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 28.02.2003 si dhe ka administruar provat materiale si në vijim :

- Procesverbalet e vendit të ngjarjes Nr.26/98 përpiluar nga ish gjyqtarja hetuese Vesna Ristic i datës 03.06.1998 dhe procesverbalet e rikonstruimit të vendit të ngjarjes nga Trupi gjykues i ish Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 10.03.2003 dhe datë 30.11.2004.
- Akt ekspertimi mjekoligjor Nr.ref.07/2003, lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore me datë 17.03.2003.
- Mendimi dhe konstatimi profesional i ekspertit mjekoligjor Dr.Flamur Blakaj, nga Instituti i Mjekësisë Ligjore me nr. ref.08/2003 i datës 20.03.2003.
- *Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 27.11.2024, është dëgjuar i dëmtuari në cilësinë e dëshmitarit E.B., i cili ka deklaruar se mbetet pranë deklarimeve të dhëna në prokurori dhe të Gjykatës së Qarkut gjatë shqyrtimit të datës 20.11.2002, duke deklaruar më tej se në ditën kritike ka qenë i akuzuari A.H., e ka parë se si ia ka sjell revolen të akuzuarit Sh., poashtu ka theksuar se është e vërtetë se i akuzuari A. ka tentuar ta vras të dëmtuarin R.B. siç ka deklaruar edhe më herët, e ka parë ditën kritike të njëjtin ku e ka goditur me kosë atë dhe vëllain e tij R.n sa ishin të kërrusur në tokë, R.n e ka goditur në pjesën e majtë të trupit te beli, ndërsa mua më ka goditur në kokë, sipas tij shtëpia e A.it ka qenë diku 150-160 metra larg nga vendi i ngjarjes, i kujtohet se e ka parë A.in duke e sjell revolen dhe duke ia dhënë të njëjtën Sh.it. Më tej ka theksuar se, në momentin kur ka shtënë Sh.i, A.i ka qenë krah për krahë me të, më tej nuk e di pasi ka marr tre plumba nga i akuzuari Sh. e që për këtë rast ka qëndruar në spital, është operuar dhe ka qenë i rrezikuar për vdekje atë ditë ai dhe R. dhe se ende i vuan pasojat pasi ka pasur operim lidhur me atë rast para 3 viteve, sipas tij prezent ka qenë dhe Xh., kur A.i e ka goditur R.n sipas dëshmitarit e ka goditur me pjesën e mprehtë të kosës duke e prerë. Krejt në fund dëshmitari ka deklaruar se ka kaluar kohë e gjatë dhe se mbetet në tërësi pranë deklarimeve të kaluara. Një deklaram të tillë ky dëshmitar e kishte dhënë dhe në procesverbalin e shqyrtimit kryesor pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë me datë 20.12.2002, i cili ndër të tjera kishte deklaruar se e ka parë babain e tij A.n duke u kacafytur me Sh.in sipas tij ata gjatë kacafytjes nuk janë rrëzuar dhe ka shtuar*

se ai ka qenë diku 10 metra larg tyre, ka qenë një kanal aty dhe prindi i tij e ka kaluar kanalën për të kaluar tek A1. motra e tij pasi e njëjta ka qenë e trishtuar dhe vetëm 13 vjeçare. Ka shtuar se Xh. ka qenë në anën e Sh.it diku pas tij diku 2-3 metra, ndërsa këta kanë qenë duke kositur dhe kur i kanë parë duke u kacafytur prindi i tij A. me Sh.in janë nisur në drejtim të tyre. Ka shtuar se *“A.in e kemi parë duke vrapuar derisa babai dhe i akuzuari Sh. janë kacafytur”*, nuk ka parë person tjetër duke ardhur përpos A.it, *“unë e kuptova se A.i pasi që e ka reperuar revolen, ka dashtë me gjujtë nga shkaku se ai revolen e ka drejtuar në drejtim tonin”*. Në këto çaste Sh.i është kthyer një hap mbrapa dhe ia ka kapur nga dora revolen A.it, ndërsa nuk e di nëse A.i ka bërë ndonjë presion apo kundërshtim që Sh.it mos të ia jap revolen, Xh. ka ndenjur pasiv, në momentin kur Sh.i ka shtënë mbi prindin e tij ai ka qenë anash tij dhe e ka parë kur babai i tij është rrëzuar, R. ka qenë pas meje ndërsa, A1. ka qenë anash, dhe kur ka gjuajtur Sh.i ka shtuar se ka ndenjur në stom kanalit dhe kosën e ka pasur në dorë ende, menjëherë pasi ka shtënë në A.n, Sh.i ka gjuajtur edhe në drejtim të tij dhe është rrëzuar pasi ka marr tre plumba, e ka parë R.n kur është drejtuar mbi prindin e tij ndërkohë *“A.i e ka goditur me kosë vëllaun R.n dhe atë në pjesën e belit në anën e djathtë”*, duke shtuar se nuk e di sa herë e ka goditur por 2-3 herë e ka parë, sipas tij *“A.i kosën e ka marr kur unë jam godit me plumba dhe kosën e kam lëshuar nga dora dhe atëherë A.i e ka marrë kosën dhe ka shkuar në drejtim të R.t pastaj u kthye prapë tek unë, unë e di se më ka goditur një herë në pjesën e kokës por nuk e di se me cilën pjesë të kosës, e që nga kjo goditje e kam humbur vetëdijen”*, në fund dëshmitari kishte deklaruar lëndimet e marra, ndërsa sa i përket revoles ka theksuar se ka qenë me ngjyre të zezë me firmën “TT” dhe të njëjtës i është dalluar ngjyra kur A.i e ka pasur në dorë.

- Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 27.11.2024, është dëgjuar dëshmitari Xh.H., i cili ka deklaruar se ka kaluar kohë e gjatë, por që mbetet në tërësi pranë deklarimeve të mëhershme. I njëjti ndër të tjera deklaroi se, ka qenë ai i pari në vend të ngjarjes e jo A.i, ka shtuar se Sh.i ka pasur armë me vete dhe e ka pasur në kerr armën e tipit “TT”, ndërsa prej familjes Berisha kanë qenë prezent A1., E.i, R. dhe A., sipas tij nga shtëpia është nisur me veturë me Sh.in ka qenë duke e dërguar të njëjtin te mjeku, kur ka dalur në afërsi të stacionit të autobusëve i ka parë lopët që kanë hyrë në grurë, kosë në dorë kanë pasur A., R. dhe E.i, ka shtuar se me kosë nuk i ka goditur askush R.n dhe E.in. Sipas tij fillimisht ka pasur përleshje mes të ndjerit (A.B.) dhe Sh.it dhe se prindi i tij e ka pasur armën në brez, sipas tij atë ditë R. nuk ka qenë i lënduar ndërsa, kur ka ndodhur ngjarja A.i nuk ka qenë prezent, ai ka ardhur pasi ka ndodhur rasti, ka qenë momenti kur unë isha duke i ndihmuar babait me krahë për tu ngjitur në shtëpinë e tyre. Sipas tij, A. dhe E.i kanë mbetur në vendin e ngjarjes ndërsa R.n e ka parë në drejtim të Sitnicës, *“A.i nuk është takuar me ta as me neve, unë e kam parë duke ardhur në drejtim tonë i kom thanë shko merre kerrin atje ku e kam lënë dhe ai nuk e ka ditë se çka ka ndodhur derisa e kemi shti babën në kerr”*, e tërë ngjarja ka ndodhur shumë shpejtë dhe A.i nuk ka pasur asnjë kontakt

fizik me anëtarët e familjes B... pasi që i njëjti ka qenë te tezja dhe nuk ka qenë në shtëpi. Sipas dëshmitarit të lënduar ka parë A.n dhe E.in afër babës të shtrirë në tokë, nuk e di a kanë qenë të lënduar apo jo, sa i përket R.n ka deklaruar se pasi kam shkuar me marrë babën pasi që ka kërcitur arma ai ka qenë në drejtim të Sitnicës duke shkuar teposhtë e as këtë nuk e kam parë të lënduar, krejt në fund ka mbetur pranë deklarimeve të dhëna më herët për këtë rast.

Dëshmitari Xh.H. në deklaratën e dhënë në procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 18.02.2003 pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë ka deklaruar se prej momentit kur është takuar me babain e tij e deri në momentin kur është sulmuar i njëjti, nuk ka zgjatur më tepër se 2-3 minuta. Sipas tij gjatë dhënies së ndihmës nuk e ka takuar asnjë person përpos I.... i cili ka ardhur i pari në ndihmë e pastaj edhe A.i, ndërsa pas dëgjimit të krismave dhe pasi i ka parë të shtrirë A.n dhe E.in dhe babain e tij i ka parë edhe dy kosa dhe njëra prej tyre e përgjakur kurse babai i tij revolen e ka pasur në brez. Sipas tij deri sa i ka dëgjuar të shtënat nuk e ka ditur se kush ka shtënë me armë deri sa ja ka parë revolen në dorë prindit të tij, A.i ka qenë te tezja e tyre në fshatin te R. F..

- Gjykata, deklaratat e dëshmitarëve dhënë në procedurën paraprake dhe në seancat e mëparshme R.B. dhe A1. Berisha i ka lexuar në shqyrtimin gjyqësor, në kuptim të nenit 335 par. 1, nën-par. 1.1 dhe 1.3 të KPP-së. Kjo për faktin se Gjykata disa herë ka tentuar që t'i sigurojë këta dëshmitarë, duke urdhëruar edhe policinë, por që kanë rezultuar të pasuksesshme, ngase sipas raporteve policore dëshmitari R.B. gjendet jashtë Kosovës në adresë të pasaktësuar, ndërsa dëshmitarja A1. Berisha kishte ndëruar adresën e mëparshme të vendbanimit, tani në adresë të panjohur por që, që të gjitha palët, në shqyrtimin gjyqësor kanë dhënë pëlqimin për leximin e deklaratave të këtyre dëshmitarëve për më tepër janë plotësuar dhe kushtet ligjore për leximin e deklaratave të tyre si më lartë.

Përveç tyre, Gjykata deklaratat e dëshmitarëve B.B. i cili në bazë të certifikatës së vdekjes Nr.ref.11/2021RV/11001 dhe nr.rendor 243 i datës 27.09.2021 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Mitrovicë, Gjykata ka konstatuar se i njëjti kishte vdekur me datë 25.04.2021, pastaj deklaratën e dëshmitarit F.B. dhe ekspertëve mjeko-ligjor Dr.Faik Bllata dhe Dr.Flamur Blakaj janë lexuar në shqyrtimin gjyqësor datë 27.11.2024, në mbështetje të nenit 335 par. 1, nën-par. 1.3 të KPP-së, duke qenë se të gjitha palët, në shqyrtimin gjyqësor kanë dhënë pëlqimin për leximin e deklaratave të këtyre dëshmitarëve dhënë në procedurën paraprake dhe në seancat e mëparshme.

- *I dëmtuari në cilësinë e dëshmitarit R.B.* në deklaratën e tij dhënë në procesverbalin e gjyqtarit hetues me datë 14.08.2002 pastaj, në procesverbalet e shqyrtimit kryesor të datës 06.01.2003 si dhe datë 28.06.2004, ndër të tjera kishte deklaruar se: ngjarja ka ndodhur atë ditë kur së bashku me prindin e tij dhe vëllaun kanë shkuar në ara për të kositur, aty ka qenë edhe motra e tij duke i ruajtur lopët, rreth orës 18:00 është ndalur vetura dhe Xh. ka ardhur të shikoj se kush është, i njëjti i ka treguar Sh.it se

nuk kanë bërë kurrfarë dëmi dhe se A. me djem është duke kositur. Kur i njëjti ka ardhur te ara babai ka shkuar te motra e cila ishte duke i ruajtur lopët dhe aty kanë fillu me u fjalos sepse Sh.i shante, *“Sh.i, A.in e drejtoj në shtëpi”* dhe sipas tij *“kur arrita gati te ta erdh A.i dhe kur u afrua Sh.i i bërtiste duke i thënë më shpejtë dhe ai duke u ofruar e repertoit revolen dhe Sh.i ia mori nga dora dhe me të shtiu në babën dhe ai u rrëzua kurse motra filloi të bërtas dhe unë shkova te ajo me qëllim të tërhjeki”*. Sipas tij në këtë çast është rrëzuar edhe E.i dhe unë ika nga plumbat, pastaj Sh.i ma drejtoi revolen dhe me siguri iu shpenzua municioni në shanzher dhe unë shkova të shikoj babën kurse motra shkoi në shtëpi me tregu se çka ka ndodhur. Sipas tij *“me kos të babës, A.i më ka goditur, e ka godit edhe E.in në kokë, e kam pa A.in se me shkelma e ka godit babën për së vdekuri dhe e shante atë”*. Pastaj sipas tij kanë ardhur disa komshi dhe atë i ndjeri Z.dhe kushëriri Di. të cilët e kanë marrë vëllain E.in pa vetëdije dhe e kanë dërguar në spital ndërsa, më vonë ka ardhur djali i Z. Xh., fqinji B.B. dhe nipi I. ku e kanë dërguar atë në spital ku ka qëndruar 7 ditë. Sipas tij A.i e ka repertitur revolen dhe ka dashur ta gjuaj babën e tij por Sh.i ia ka marr nga dora dhe ka shtënë në babën e tij. A.i ka qenë pranë Sh.it, ndërsa Xh. ka qenë larg E.it dhe të dy kanë qenë në rrugën tjetër përtej kanalit. Menjëherë Sh.i ka gjuajtur në drejtim të E.it dhe me aq sa i kujtohet 3 herë e ka goditur. Sipas tij kur e ka larguar motrën ka shkuar te prindi i tij i cili ishte ende gjallë dhe ka shtuar se *“unë isha i krusur në babën dhe në këtë çast e kam pa A.in pas meje pasi që ai më parë më shau dhe kjo ma tërhoqi vëmendjen të shikoj mbrapa, e kam kthyer kryt në të majtë dhe e kam pa A.in me kos në dorë, me siguri kjo ka qenë kosa e babës dhe ai është has me kos dhe me të më ka goditur një herë në shpinë në pjesën e belit në anën e majtë sipas tij e ka tërhequr trupin me qëllim që ti shmangem goditjes por prape ai me kos më ka goditur, dhe sipas tij në këtë nxehtë nuk e kam ditur se jam i prerë dhe jam larguar pak kurse A.i ka shkuar dhe me shkelma e ka goditur 2-3 herë babën dhe ka shkuar te E.i dhe E.in e ka goditur me shkelma, nga këto goditje nga shkelmat trupi i E.it ka lëvizur nga vendi dhe E.i nga këto goditje me kokë ka ra në kos e cila ishte në tokë dhe është prerë”*. Sipas tij i gjithë konflikti ka ardhur ashtu që Sh.i erdh te baba i tij duke sharë dhe aty kanë filluar të shtyhen me duar dhe nuk e di se cili i pari e ka shty tjetrin. Deklaratë pothuajse të njëjtë dëshmitari ka dhënë edhe në procesverbalin e shqyrtimit kryesor me datë 06.01.2003 duke shtuar se kosa me të cilën A.i e ka goditur ka qenë ose e E.it ose e babës së tij, ndërsa sa i përket goditjeve mbetet si në deklaratën e dhënë në hetuesi. Sipas tij sa i përket plagës të cilën e ka pësuar në pjesën e majtë të mbi belit ka qenë diku rreth 10-12 cm në formë të harkut dhe ka qenë plagë prerëse, dhe se me rastin e intervenimit ka pasur 13-14 lidhëse dhe një plagë tjetër e ka pasur pa teh të kosës dhe me siguri me qenë me trup të kosës pasi nuk ka qenë e dukshme e njëjta ka qenë në formë të ndrydhjes. Gjithashtu në shqyrtimin e kryesor të datës 28.06.2004 ka deklaruar njëjtë si në deklaratat e kaluara duke shtuar se *“jam i sigurt se A.i më ka goditur”*, duke shtuar se nuk e ka dëgjuar Sh.in ta ketë dërguar A.in me marr revolen por nga fakti se A.i erdhi me revole ka supozuar se e kanë bërë marrëveshje.

- *Dëshmitarja A1. B.* në deklaratat e saj dhënë në procesverbalin te gjyqtari hetues me datë 13.08.2002 si dhe në procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 28.01.2003, kishte deklaruar se: kur ka ndodhur ngjarja ka qenë 14 vjeçe, sipas saj atë ditë ka shkuar me babën e saj për ti ruajtur lopët, ka qenë diku rreth 5 metra larg tyre, ka ardhur një veturë dhe janë hapur të gjitha dyert dhe fillimisht ka ardhur Xh. dhe i ka thënë babës ku i pate lopët dhe ai pastaj u kthye dhe erdhi i akuzuari i cili ka shajt dhe i ka rënë me revole babait dhe i njëjti është rrëzuar sipas saj prindi i saj e ka lëvizur dorën dhe pastaj me revole ka qëlluar prapë babin e saj e pastaj edhe vllaun. Sipas dëshmitares kanë ardhur fillimisht Sh.i me Xh.n pastaj dikur pesë metra ka qenë Sh.i me A.in dhe i njëjti i thotë A.it të shkonte t'ia binte revolen kurse ne te tjerët ishim bashkë. Ka shtuar se e ka dëgjuar kur i ka thënë por më nuk e di pasi ka qenë e shqetësuar dhe tutje shton se Sh.i me djemtë Xh.n dhe A.in kanë ardhur te baba i saj në arë ku ka qenë duke kositur, dhe e ka parë kur A.i ia ka dhënë armën Sh.it dhe e di se A.i e ka pasur veshur një jelek të zi pancir dhe ne jelekun montë të fryer me gjepa. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 28.01.2003 dëshmitarja ka deklaruar njëjtë si në hetuesi duke shtuar se Sh.i ia ka drejtuar armën edhe asaj dhe se prindin e saj e kanë shkelmuar edhe sa ka qenë i rrëzuar dhe ka shtuar se “*Sh.i i tha A.it bima revolen, A.i shkoj dhe ja ka sjell revolen shpejtë*”. Tutje ka deklaruar se “*A.i i ka sjell vëllaut E.it, i cili ka qenë në ato momente i shtrirë, pastaj me kos në pjesën e kokës e ka goditur E.in e pastaj me kos e ka goditur edhe R.n në bel nga pjesa e mbrapa shpinës*”. Sa i përket Xh.t e njëjta ka deklaruar se ka qenë prezent mirëpo nuk ka marr ndonjë veprim.

- *Dëshmitari B.B.* në deklaratat e tij dhënë në procesverbalin te gjyqtari hetues me datë 13.08.2002 si dhe procesverbalet e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 29.01.2003 dhe 17.02.2003, përveç tjerash kishte deklaruar se: ngjarja ka ndodhur rreth orës 18:00 dhe ka qenë në bashqen e tij e cila ndodhet rreth 300 metra larg arës ku ka qenë A. me dy djemtë e tij, ka shtuar se te stacioni rreth 150 metra larg tij me kerr e ka parë Sh.in, ndërsa djali i Sh.it ka shkuar rrugës afër tij ndërsa Sh.i trup grurit në drejtim të A.t, atje deklaroi se nuk e di se çfarë ka ndodhur po ka dëgjuar të shtënat me revole, e ka parë pastaj Sh.in duke shkuar përpjetë grurit me revole në dorë ndërsa vajza e A.t që i ruante lopët ka bërtitur dhe i shkonte pas Sh.it, Ka shtuar se Sh.i ka kaluar pranë tij dhe nuk i ka folur dhe ka dal te vendi i ngjarjes dhe ka shtuar se “*e kam parë djalin e A.t të shtrirë në stom të kanalit, A.n në rrugë, stom rruge dhe atë kokën në grurë kurse trupin në rrugë, A. kishte të goditur koken, në zemër dhe e pash këmbën e djathtë të tij të përgjakur, si dhe e kam pa edhe djalin tjetër te A.t duke bërtitur dhe se kishte qenë i goditur me kos në bel kah shpina*”. Pastaj sipas dëshmitarit kanë ardhur edhe Z....., kushëriri i A.t dhe i kanë dërguar në spital, tutje dëshmitari ka deklaruar se Sh.in e ka parë duke zbritur prej veturës e di se afër tij në rrugë ka kaluar djali i madh i Sh.it A.i. Ka shtuar se ka dëgjuar vetëm një të shtënë pasi me veshin e djathtë është i shurdhër dhe ka shtuar se “*A.i djali i Sh.it ka qenë në vendin e ngjarjes kur ka ndodhur ngjarja por nuk e di se çka ka bërë ai atje*”, duke shtuar se i njeh djemtë e Sh.it pasi i ka

fqinjë dhe se në vendin e ngjarjes ka parë A.n e vdekur dhe dy djemtë e tij të lënduar, sipas tij Xh.n nuk e ka parë në vendin e ngjarjes. I njëjti dëshmitarë gjatë seancës kryesore të datës 17.02.2003 ka deklaruar pothuajse njëjtë si në hetuesi duke shtuar se *“djali i Sh.it ka qenë poshtë kur A. dhe Sh.i janë kaqumit por nuk e di se sa larg tyre ka qenë pasi nuk e kam pa”*.

- *Dëshmitari F.B.* në deklaratat e tij dhënë në procesverbalin të gjyqtari hetues me datë 14.08.2002 si dhe në procesverbalet e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 06.01.2003 dhe datë 14.09.2021, i njëjti ka deklaruar se ditën kritike ka qenë duke u kthyer nga qyteti me autobus, nga autobusi e ka parë Sh.in jashtë veturës së tij afër stacionit në cep të rrugës dhe ka shkuar në shtëpi dhe pas 10 minutave ka dal për të punuar në bashqë të tij kur *“nga rruga e asfaltuar në drejtim të shtëpisë së Sh.it larg dyerve të oborrit rreth 3 metra ishte duke ardhur djali i Sh.it A.i, ai shpejtonte, ectë shpejtë dhe kur hyri në dyert dyert kërcitën pasi i njëjti nuk i mbylli”*, sipas tij pas 3-5 minuta ka parë duke dal A.in pas tij edhe vëllau i tij Valdeti me shati në dorë e pas tij edhe vëllau i Sh.it I..... po ashtu me shati në dorë, e di se pas një kohe të shkurtë ka dëgjuar të shtëna me armë dhe ka shtuar se *“kur ka dalur A.i nga dyert e kam pa se ai diçka ishte duke mbështjellur me duar nëpër xhepa dhe trup dhe nuk di se çka ashtu bënte dhe nuk e kam pa se çka ka pasur ai me vete”*. Ka shtuar se ka shkuar pastaj në vendin e ngjarjes e ka parë duke e dërguar E.in për në spital e pastaj edhe R.n, ndërsa A.n e ka parë të shtrirë dhe të vdekur.

Deklaratë të njëjtë dëshmitari ka dhënë edhe në procesverbalin e shqyrtimit kryesor, duke shtuar se kur ka arritur në vendin e ngjarjes ka parë plagët tek i ndjeri A., ka vërejtur te R. gjak në pjesën e kokës. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 14.09.2021, dëshmitari ka deklaruar njëjtë si në deklaratat e kaluara duke shtuar se kur ka dal në vendin e ngjarjes e ka parë dëshmitarin Z.I., dhe dy vëllezërit e të ndjerit A., sipas tij e ka parë të ndjerin dhe i ka parë tri plagët që i ka marrë, dëshmitari tutje ka deklaruar se me aq sa i kujtohet e di se e ka parë A.in ditën kritike pasdite, ka shtuar se më nuk e ka parë A.in duke hyrë apo dal pasi menjëherë pasi e ka kuptuar se A. është vrarë ka dal në vendin e ngjarjes. Dëshmitari tutje është ballafaquar me deklaratën e dhënë tek gjyqtari hetues ku kishte deklaruar se *“e ka parë A.in së bashku me vëllaun e tij V..... me një shati në duar e pas tyre vëllau i Sh.it, I..... gjithashtu edhe ai me shati në dorë”*, dëshmitari ka deklaruar se e ka parë vetëm A.in dhe atë për 2-3 sekonda ndërsa të tjerët nuk i ka parë, duke shtuar se ka qenë kohë lufte, ka qenë në burg dhe ka pasur probleme dhe nuk ka qenë në gjendje të mirë mendore.

- *Lidhur me deklaratën e Dr.Faik Bllata* dhënë në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 29.01.2003, deklaratë kjo e cila lidhet me të akuzuarin Sh. H. për të cilin ka përfunduar çështja penale ndaj tij (*shih: Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.nr.325/2005 datë 15.06.2005*) meqenëse prokurorja ka propozuar që të lexohet, atëherë Gykata sqaron se i njëjti kishte deklaruar se: data e saktë nuk i kujtohet por e di se ka qenë fundi i majit apo fillimi i qershorit dhe ka qenë në

shtëpinë e tij në Vushtrri ku edhe e ka pasur ambulanten, e di se ka ardhur një automjet nuk është i sigurt se kush por ndoshta B.P. dhe i njëjti e ka dërguar në një familje dhe aty ju ka dhënë qetësues asaj familjeje në fshatin nga se në atë familje kishte humbur jetën një anëtarë i familjes, ka shtuar se me tu kthyer në shtëpi e ka vërejtur se e priste G.B., i njëjti e ka marr dhe i ka thënë se në shtëpinë e tij e ka një person të lënduar dhe nuk kanë mundur ta sjellin në spital, sipas tij tek i lënduari ka vërejtur femurin e këmbës së majte dhe në pyetje ishte plaga tej shpuese (nga ana e jashtme) për vërtetim të saktë në pyetje ka qenë plaga pësuar mbi gjurin e këmbës së majtë, sipas tij e ka pastruar plagën dhe e ka qepur dhe ja ka dhënë terapinë adekuate. Sipas tij fillimisht nuk e ka ditur se çfarë ka ndodhur por G..... i kishte thënë se është lënduar me kos duke kositur, sa e ka vërejtur i lënduari e ka pasur edhe një gërvishtje të vogël në krahun-llërën e majtë dhe një goditje- plagë ndrydhëse në dromë të hematomit në ballë me sa i kujtohet në anën e majtë me gjakderdhje lëkurore. Sipas tij i lënduari ka qenë i shqetësuar dhe i ka thënë se ka pasur fat në plagë pasi sikur plaga të ishte në anën tjetër, i ka thënë se nuk do të vinte te ti fare, dhe i dëmtuari sipas tij i ka thënë fat i madh kishte me qenë sikur të kisha mbete i vdekur atje, dhe dëshmitari ka deklaruar se pak a shumë aty e ka kuptuar se çfarë kishte ndodhur, dëshmitari është udhëzuar gjatë seancës të deklarohen se për këndë e ka fjalën dhe dëshmitari në sallën e gjykimin është drejtuar tek i akuzuari Sh. H.. Sipas dëshmitarit këto plagë kanë qenë të asaj dite pasi kanë qenë të freskëta dhe e di se përpos Ganiut dhe Sh.it në atë shtëpi ka qenë edhe një person tjetër por nuk e di se kush ka qenë ai.

- *Eksperti mjeko ligjor Dr.Flamur Blakaj* në deklaratën e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 28.02.2003, ndër të tjera kishte deklaruar se: pas shikimit të të lënduarve kishte theksuar se Sh. H., në mesin e llërës së majtë rreth 18 cm nën cepin e krahut në faqen e jashtme të tij do të thotë leteres së majtë lëkura paraqitet me ngjyrë të bardhë se indi për rreth me trajtë vizore dhe pjesët të boshtit gjatësore të llërës me përmasa 14x2 mm dhe jo mirë e kufizuar me indin përreth, ky dëmtim paraqitet në nivel të indit për rreth me ngjyrë pak sa më të bardh se ajo e indit normal. Në faqen e jashtme dhe të pasme të kofshës së majtë rreth 20 cm nën ashtin e çapokut (ashti i legenit) ndahet në vraje (cikatriks) në trajtë boshtore me ngjyrë të kuqe deri në vjollce me përmasa 47x5 mm kjo vraje është gati paralele me boshtin gjatësor të ashtit të kofshës (femurit). Në regjionit e gilcës së majtë rreth 15 cm nën ashtin e çapokut ndodhet ndaja në trajtë boshtore me ngjyrë hiri me nuanca të ngjyrës së kuqërremtë me përmasa 50x7mm kjo vraje është paralele me boshtin gjatësorë të ashtit të kofshës.

Për të dëmtuarin E.B., eksperti ka deklaruar se në anën e majtë të pjesës së përparme të kafazit të kraharorit rreth 4cm larg dhe poshtë gjirit të majtë dhe 7 cm nga vija e mesme e trupit ndodhet vraje në trajtë vezake me e ngritur se indi për rreth me ngjyrë të bardhë deri në të hirit me përmasa 14x11 mm, në pjesën e majtë të regjionit të shpinës që i përgjigjet pjesës së poshtme të kafazit të kraharorit rret 9 cm nga vija e mesme e shpinës dhe 16 cm nga eshtrat e legenit ndodhet gjithashtu një vraje në

trajtë vezake me karakteristike të ngjashme me atë të përshkruara si më sipër dhe me përmasa 15x12 mm, në anën e djathtë dhe të poshtme të barkut rreth 9 cm djathtas dhe poshtë kërthizës dhe 7 cm nga vija e mesme e trupit ndodhet një vraje tjetër me përmasa 12x7 mm me karakteristika dhe veçori të ngjashme me të lartshënuara. Në regjionin e kilces së majtë rreth 15 cm nën çapokun e e majtë ndodhet nraja në trajtë boshtore paralel me boshtin gjatësor të kofshës me ngjyrë të kuqërremte me përmasa 65x12 mm, në regjionin e djathtë të kokës rreth 5 cm mbi cepin e veshit të djathtë ndodhet një vraje me ngjyrë të bardhë me e zbehur se lëkura e indit për rreth diçka më e ngritur se ajo, flokët në këtë regjion mungojnë dhe ka trajtë të gjysmë hënës apo draprove me konkavitete të kthyer nga prapa përmasat e kësaj vraje janë 60x4 mm.

Sa i përket të dëmtuarit R. B., eksperti ka deklaruar se në anën e majtë të regjionit të shpinës rreth 6 cm nga vija e mesme e shpinës dhe 15 cm nga çapoku i majtë ndodhet vraja apo cikatyrikes në trajtë boshtore i pjesët me boshtin gjatësor të trupit me ngjyrë të kuqërremte me përmasa 80x4 mm.

Pas administrimit të provave, i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij nga neni 319 par.2 i KPP-së, në cilësinë e palës së akuzuar në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 21.01.2025, dhe i njëjti ka shfrytëzuar të drejtën e tij që të mbrohet në heshtje lidhur me çështjen penale që akuzohet. Gjykata ka konstatuar se kjo është e drejtë ligjore e të akuzuarit përcaktuar në nenin 344 par.1 të KPP-së, të cilën ka zgjedhur i akuzuari ta shfrytëzojë.

- Vlerësimi i gjykatës –

- Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve, dhe administrimit të provave materiale të lartë cekura, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku në përputhje me nenin 360 të KPP-së, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë të kësaj çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se sa i përket veprave penale, rikualifikuar nga Prokurorja e shtetit në shqyrtimin gjyqësor të datës 04.02.2025, dhe atë ndihmë në Vrasje në çast nga neni 33 i LPK-së e lidhur me nenin 24 të LPJ-së dhe Vrasje në çast në tentativë nga neni 33 të LPK-së e lidhur me nenin 19 dhe nenin 24 të LPJ-së, Gjykata vlerëson se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, ndërsa gjen se në veprimet e të akuzuarit A.H. përmbushen elementet e veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së e lidhur me nenin 19 të LPJ-së.

- Nuk është kontestuese se më datë 02.06.1998 rreth orës 18:10 minuta, në vendin e ashtuquajtur “.....” në fshatin, komuna e Mitrovicës, ka ndodhur një përleshje mes familjesdhe familjes, nga ku kishte humbur jetën A.B..

- Nuk është kontestues as fakti se Sh. H. është shpallur fajtor për vrasjen e të ndjerit A.B., gjithashtu kontestues në këtë çështje nuk ishte as fakti se lëndime trupore kishin pësuar edhe djemtë e të ndjerit përkatësisht E. dhe R.B..

- Po ashtu, nuk ishte kontestues fakt se ditën kritike i ndjeri A.B. së bashku me djemtë e tij E. e R.B. kanë qenë në arat (livadhet) e tyre duke kositur me kos, ndërsa më tej kishte qenë dhe vajza e tij A1. B., duke u kujdesur për gjedhet (lopët).

- Këto fakte, përveç që nuk janë kontestuar nga i akuzuari, vërtetohet edhe nga provat e administruara, respektivisht nga provat materiale.

Mbi bazën e këtyre fakteve të lartcekura, kontestuese në këtë çështje penale ishte fakti se i akuzuari A.H., a ka qenë në vendin e ngjarjes dhe nëse i njëjti ka ndërmarr veprime në drejtim të kryerjes së veprës penale ndaj të dëmtuarve E. dhe R.B..

- Gjykata vëren së prokuroria në aktakuzën e saj pretendon se i akuzuari A.H., me dashje i ka ndihmuar prindit të tij të akuzuarit Sh. në kryerjen e veprës penale të vrasjes ndaj tani të ndjerit A.B. dhe vrasjes në tentativë ndaj të dëmtuarit E.B. në atë mënyrë që me kërkesën e të akuzuarit Sh. kishte shkuar në shtëpinë e tyre kishte marr armën, e kishte repertuar dhe ja ka dorëzuar të akuzuarit Sh. në mënyrë që i njëjti ta përdor me shpejtë dhe më lehtë.

Gjithashtu i akuzuari A.H. akuzohet se me dashje ka filluar veprën penale të vrasjes ndaj të dëmtuarit R.B., e cila vepër ka mbetur në tentativë, duke menduar se i njëjti e ka përfunduar ashtu që të njëjtin e godet me kos me tehun e saj njëherë në pjesën e ijëve, gjatë kohës kur i dëmtuari ka qenë duke qëndruar mbi prindin e tij të ndjerë duke i shkaktuar të njëjtit plagë prerëse e cila është e natyrës së rëndë trupore.

- Vlerësimi i Gjykatës për pikën –I- të dispozitivit të Aktgjykimit -

- Lidhur me pikën –I- të dispozitivit të aktgjykimit Gjykata rikujton se, Prokurorja e shtetit, në shqyrtimin gjyqësor të datës 21.01.2025 me rastin e paraqitjes së fjalës përfundimtare, paraprakisht për pikën III të aktakuzës ka bërë ri kualifikimin e veprave penale nga ajo si në aktakuzë, në veprën penale ndihmë në Vrasje në çast nga neni 33 i LPK-së e lidhur me nenin 24 të LPJ-së dhe Vrasje në çast në tentativë nga neni 33 të LPK-së e lidhur me nenin 19 dhe nenin 24 të LPJ-së, për të cilën vepër penale parashihet dënim me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vite.

- Ndërlidhur me këtë rikualifikim të veprave penale, Gjykata sipas detyrës zyrtare ka analizuar dispozitat ligjore të LPJ-së ligj i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, të cilat kanë paraparë parashkrimin e ndjekjes penale për veprat penale të dënueshme me burgim deri në dhejtë (10) vjet.

Pra, në nenin 95 par.1, nënpar.3 të LPJ-së, është përcaktuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar *“dhjetë vjet nga kryerja e veprës penale për të cilën në bazë të ligjit mund të jepet dënim me mbi pesë vjet burgim”*. Ndërsa, sipas nenit 96 par.6 të LPJ-së, është përcaktuar se *“parashkrimi i ndjekjes penale lind në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës që kërkohet në bazë të ligjit për parashkrimin e ndjekjes penale”*.

- Në rastin konkret tani i akuzuari është akuzuar për kryerjen e veprës penale të rikualifikuar ndihmë - Vrasje në çast nga neni 33 i LPK-së e lidhur me nenin 24 të LPJ-së dhe Vrasje në çast në tentativë nga neni 33 të LPK-së e lidhur me nenin 19 dhe nenin 24 të LPJ-së, për të cilën vepër penale parashihet dënim me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vite.

- Në bazë të përshkrimit faktik të veprave penale si në pikën III të dispozitivit të aktakuzës, i akuzuari veprat penale dyshohet t'i ketë kryer me datë 02.06.1998 dhe sipas kësaj ka kaluar dyfishi i afatit të parashkrimit të paraparë për këtë vepër penale dhe në bazë të nenit 96 par.6 të LPK-së, në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrimin absolut të ndjekjes penale, e që në këtë rast nga data 02.06.1998 deri me datën 02.06.2018 rezulton se kanë kaluar njëzet (20) vite, pra ka kaluar dyfishi i kohës që kërkohet për arritjen e parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

- Prandaj, Gjykata konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, e pamundëson Gjykatën që ligjërisht të ndërmerr ndonjë veprim në drejtim të ndjekjes penale e për pasojë është rrethanë që pengon ndjekjen penale. Ashtu që kjo Gjykatë, pasi ka vërtetuar se ndaj të akuzuarit A.H., sa i përket pikës III të aktakuzës për veprat penale rikualifikuar-Vrasje në çast nga neni 33 i LPK-së e lidhur me nenin 24 të LPJ-së dhe Vrasje në çast në tentativë nga neni 33 të LPK-së e lidhur me nenin 19 dhe nenin 24 të LPJ-së, ka arrit parashkrimi absolut i ndjekjes penale për të njëjtat dhe nga këto arsye kjo Gjykatë e ka refuzuar akuzën duke u bazuar në dispozitën e nenit 362 par.1, nënpar.1.3 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 362 par.1 i KPP-së përcakton se : *“Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur : nënpar.1.3 “ka kaluar afati i parashkrimit dhe vepra përfshihet në amnisti ose falje, ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që përjashtojnë ndjekjen penale”*.

- *Vlerësimi i Gjykatës për pikën –II- të dispozitivit të Aktgjykimit –*

- Gjykata rithekson se ka vepruar sipas vërejtjeve të dhëna në aktvendimin e sipërtheksuar të Gjykatës Supreme të Kosovës ashtu që, në rigjykim nuk administroi prova të reja, nga se nuk kishte propozime nga palët subjekte në procedurë penale për një gjë të tillë, por edhe sipas detyrës zyrtare gjykata ka vlerësuar se nuk është nevojshme nxjerrja e provave të reja për këtë çështje penale dhe në rigjykim

vetëm i vlerësoi provat ekzistuese ashtu që, Gjykata ka vazhduar me këtë çështje penale dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Sa i përket pikës II të dispozitivit të aktgjykimit, Gjykata kishte parasysh provat materiale administruar në shqyrtim gjyqësor si dhe ato personale, të cilat janë të ndërlidhura me të akuzuarin Sh. H. për të cilin ka përfunduar procedura penale ndaj tij me aktvendim të formës së prerë (*shih: Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.nr.325/2005 datë 15.06.2005*), me tani të akuzuarin A.H., por që ka vlerësuar se këto prova duhet të shqyrtohen dhe vlerësohen tani në raport me të akuzuarin A.H., se si ka ndodhur rrjedha e ngjarjes në këtë rast, e marrë parasysh faktin se ky rast ka ndodhur në të njëjtën kohë dhe vend përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit madje dhe dëshmitarët e rastit kanë qenë të njëjtë, mirëpo Gjykata rithekson se do të jap sqarime më tepër në drejtim të tani të akuzuarit A.H. lidhur me veprën penale si në pikën IV të dispozitivit të aktakuzës.

- Nga administrimi i provave materiale në shqyrtimin gjyqësor, me theks të veçantë ato materiale dhe personale Gjykata ka arritur të vërtetojë se janë plotësuar elementet e veprës penale për pikën IV të dispozitivit të aktakuzës- Vrasje në tentativë nga neni 30 al.1 të LPK-së e lidhur me nenin 19 të LPJ-së, dhe atë si në vijim :

- Nga Procesverbalet e vendit të ngjarjes Nr.26/98 përpiluar nga ish gjyqtarja hetuese Vesna Ristic i datës 03.06.1998 vërtetohet se është bërë rikonstruimi i vendit të ngjarjes në fshatin, komuna e Mitrovicës, në vendin ku një person ka mbetur i vrarë, në vendin e quajtur “.....”, po ashtu vërtetohet se në vendin e ngjarjes ka mbetur i vrarë A.B., ndërsa i lënduar nga arma e zjarrit ka mbetur E.B., të cilët janë goditur me armë zjarri nga Sh. H., në vendin e ngjarjes ka qenë edhe R.B. i cili ka marr lëndime nga A.H., ndërsa është konstatuar se në vend të ngjarjes ka qenë edhe dëshmitari Xh.H..

- Nga Procesverbalet e rikonstruimit të vendit të ngjarjes, për të cilat është kujdesur Trupi gjykues i ish Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 10.03.2003 dhe datë 30.11.2004, vërtetohet se dëshmitari Xh.H. në vendin e ngjarjes ka shpjeguar vendin ku është ndalur me automjetin e tij ditën kritike, dhe atë përball shtëpisë së R.B., pastaj përshkruhet se nga ai vend i ka parë lopët në arën e tij dhe nga ai vend është nisur të shkoj në drejtim të lopëve dhe ka shpjeguar se pasi i ka trembur lopët duke u kthyer të vetura ka parë babain e tij Sh.in dhe me të njëjtin janë takuar te ura që i lidh dy rrugët që shpijnë tek ara, ka përshkruar vendin ku kanë qenë duke kositur të dëmtuarit, e gjithë rrjedha e përshkrimit është fotografuar dhe precizuar nga pjesëtarët e krimit teknik, ka përshkruar vendin ku janë takuar i ndjeri A. me të pandehurin Sh., ka përshkruar përleshjen mes tyre ku sipas tij A. me kos e ka goditur Sh.in dhe atë dy herë me qyk të kosës e ka goditur në ballë një herë në anën e majtë njëherë në anën e djathtë

dhe një herë me teh të kosës në pjesën e mbi bërrylit të dorës së majtë, sipas tij ka përshkruar se si e kishte kapur të ndjerin A. me dy duart e tij duke e bartur përmes rrugës që lidh rrugën, se në atë moment djemtë e A.t, E.i dhe R. kanë qenë në pjesën ku ka qenë Sh.i se gjersa ka qenë duke e mbajtur të ndjerin ka dëgjuar Sh.in duke i thënë “ruju se po të presin”, ka lëshuar të ndjerin dhe ka parë E.in me dy duart të ngritura lartë dhe kosën me teh të drejtuar kah ai duke u përgatitur ta sulmoj, sipas tij A. ka shkuar në drejtim të Sh.it dhe në ato çaste është dëgjuar krisma, pasi është kthyer në stom të kanalit ka deklaruar se e ka gjetur A.n të shtrirë dhe E.in njërin pas tjetrit, dhe ka vërejtur gjak të prindi i tij Sh.i.

- Nga rikonstruimi i vendit të ngjarjes, i dëmtuari E.B. ka precizuar vendin ku kanë qenë duke kositur pastaj edhe vendin e ngjarjes, ka shpjeguar vendin ku janë takuar me Xh.n, vendin ku janë takuar Xh. me Sh.in, shpjegon se si i ndjeri A. me kos në dorë ka shkuar dhe janë takuar me të njëjtit dhe se janë kacafytur, se si i ndjeri A. me Sh.in janë ndarë në anën tjetër të kanalit dhe se e ka parë A.in duke vrapuar, përshkruan rrugën nga ka ardhur A.i, se si i akuzuari Sh. është kthyer një hap mbrapa e ka marr revolen dhe ka shtinë në drejtim të A.t e pastaj edhe në drejtim të tij.

Po ashtu, i dëmtuari R.B. ka përshkruar vendin ku kanë qenë duke kositur, mënyrën e kacafytjes mes Sh.it dhe A.t, ka përshkruar se si ka ardhur A.i me revole në dorë të cilën ia ka marr Sh.i nga dora dhe në atë moment në anën tjetër të kanalit ka qenë E.i ndërsa pak më poshtë në atë anë të kanalit ka qenë A., ka shpjeguar se i akuzuari Sh. ka shtënë së pari tek A. e pastaj në E.in, gjithashtu ka përshkruar se si i akuzuari A. e ka goditur me kos në bel.

Dëshmitari B.B. kishte shpjeguar vendin ku ka qenë në bashqen e tij, vendin ku e ka parë të akuzuarin A., ka shpjeguar vendin ku i ka gjetur dy kosa e në fakt është ara e Sh.it e lopët duke kullotur në kanal, vendin ku ka qenë i shtrirë i ndjeri A. dhe E. afër tij.

Gjithashtu dhe dëshmitari F.B. ka shpjeguar vendin ku e ka parë A.in e në fakt është në pjesën e epërme ka është rruga e asfaltuar e shtëpisë së tij, shikueshmëria është e mirë.

I akuzuari A.H., kishte shpjeguar rrugën prej nga ka ardhur nga tezza e tij dhe vendin ku i ka parë Xh.B pastaj S....., vendin nga e ka parë automjetin e parkuar dhe nga ai vend është mundur qartë të shihet automjeti i parkuar.

- Nga akt ekspertimi mjekoligjor Nr.ref.07/2003, lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore me datë 17.03.2003, Gjykata do të jap shpjegime vetëm lidhur me lëndimet e konstatuara trupore për të dëmtuarin R.B., që ka të bëjë me veprën penale sipas pikës IV të aktakuzës. Nga e njëjta ekspertizë tek ky i dëmtuar konstatohen lëndimet 1. Në anën e majtë të regjionit të shpinës rreth 6 cm nga vija e mesme e saj dhe 15 cm nga çapoku i majtë ndodhet vraja në trajtë boshtore e pjerrët me boshtin gjatësor të trupit, me ngjyrë të kuqërremtë më e ngritur se indi përreth me përmasa 80x4 mm.

- Nga mendimi dhe konstatimi profesional i ekspertit mjekoligjor Dr.Flamur Blakaj me nr. ref.08/2003 i datës 20.03.2003, vërtetohet se konstatimi është bërë bazuar në ekzaminimin e personave të dëmtuar, në rastin konkret të dëmtuarit R.B. pastaj, në dokumentacionin e lëndës në tërësi, në rikonstruksionin e vendit të ngjarjes bashkë me foto dokumentacionin në shkresat e lëndës.

Eksperti ndër të tjera, sa i përket të dëmtuarit R.B., ka konstatuar se dëmtimi i përshkruar tek ky i dëmtuar është një cikatriks me karakteristika dalluese jo specifike me trajte boshtore, që është vështirë të thuhet në mënyrë shkencore se me çfarë mjete është shkaktuar por ekziston mundësia e shkaktimit të tij me *anë të veprimit mekanik të mjetit prerës*.

- Vlerësimi i provave –

- Pas vlerësimit të të gjitha rrethanave Gjykata gjen se veprimet e të akuzuarit, përkatësisht sulmi që i akuzuari A.H. ka ndërmarr në drejtim të dëmtuarit R.B., qartë dëshmon dashjen e tij, për të privuar nga jeta të dëmtuarin. Provat e rastit, dëshmojnë se i akuzuari ka vepruar me dashje direkte apo të drejtpërdrejtë. I akuzuari ka qenë i vetëdijshëm se veprimet e tij, përkatësisht sulmi dhe goditjet me kosë ndaj të dëmtuarit mund të shkaktojnë pasoja të paparashikueshme dhe mund t'ia rrezikojë drejtpërdrejtë jetën e tij. Përkundër kësaj, i akuzuari e kishte sulmuar dhe goditur me kosë të dëmtuarin në pjesën vitale të trupit dhe atë në pjesën e shpinës, fakt të cilin gjykata e ka vërtetuar nga vetë i dëmtuari R.B. dhe dëshmitarët E.B. dhe A1. B. të cilët kanë qenë prezent ditën kritike, për më tepër të njëjtit në mënyrë të saktë, të qartë dhe në mënyrë identike kanë përshkruar momentin se si i akuzuari e ka goditur me mjet-kos bari të dëmtuarin në pjesën e shpinës.

Ndërlidhur me këtë, vlenë të theksohet fakti tjetër qenësor lidhur me lëndimet e pësuarat të të dëmtuarit dhe mjetin me të cilin i janë shkaktuar të njëjtat, vërtetohet nga akt ekspertimi mjekoligjor Nr.ref.07/2003, lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore me datë 17.03.2003 si dhe nga mendimi dhe konstatimi profesional i ekspertit mjekoligjor Dr.Flamur Blakaj me nr. ref.08/2003 i datës 20.03.2003, nga të cilat është konstatuar se lëndimet tek ky i dëmtuar janë paraqitur 1. Në anën e majtë të regjionit të shpinës rreth 6 cm nga vija e mesme e saj dhe 15 cm nga çapoku i majtë ndodhet vraja në trajtë boshtore e pjerrët me boshtin gjatësor të trupit, me ngjyrë të kuqërremtë më e ngritur se indi përreth me përmasa 80x4 mm, të shkaktuara me *anë të veprimit mekanik të mjetit prerës*.

Ndërlidhur me këtë Gjykata ka konstatuar se, i akuzuari ka qenë i vetëdijshëm se mjete të cilën e ka përdorur për ta sulmuar të dëmtuarin paraqet një mjet të rrezikshëm dhe që mund të shkaktohen pasoja fatale për jetën e të dëmtuarit. Prandaj, dashja e të akuzuarit për ta privuar nga jeta të dëmtuarin ka ekzistuar që prej momentit të përdorimit të kosës si mjet për sulm, përkatësisht nga fillimi dhe vazhdimi i sulmit me të ndaj të dëmtuarit dhe gjersa kishte menduar se të njëjtin e ka privuar nga jeta.

- Faktin se a ka qenë i akuzuari A.H. në ditën kritike në vendin e ngjarjes kur ka ndodhur rasti dhe a i ka ndërmarrë i njëjti veprimet me mjet-kos bari në drejtim të të dëmtuarit R.B., para se gjithash Gjykata e ka vërtetuar nga vetë i dëmtuari, pastaj dëshmitarët E. e A1. B., e pjesërisht dhe nga dëshmitarët B.B. e F.B., për të cilët Gjykata do të jap vlerësimet e saj lidhur me dëshmitë e tyre si në vijim.

- Pra, Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari A. ka qenë në vendin e ngjarjes ditën kritike, përkundër pretendimeve të tij se nuk ka qenë, se i njëjti ka qenë në vendin e ngjarjes dhe ka ndërmarrë veprime në drejtim të kryerjes së veprës penale vërtetohet nga i dëmtuari R.B. i cili ka qenë konsistent në deklaratimet e tij qysh para gjyqtarit hetues, gjatë rikonstruimit të vendit të ngjarjes dhe deklaratave tjera të dhëna në Gjykatë. Gjykata e ka marrë të besueshme dëshminë e të dëmtuarit që ka dhënë për këtë rast në prokurori dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor. Së pari, i dëmtuari ka qenë dëshmitar okular, përveç se e ka pa ngjarjen edhe e ka përjetuar atë drejtpërdrejt si i dëmtuar. Kjo rrethanë na jep të kuptojmë se i dëmtuari e ka përjetuar dhe perceptuar deri në detaje ngjarjen që ka ndodhë më datën 02.06.1998. Gjithashtu, i dëmtuari e ka identifikuar të pandehurin menjëherë pas ngjarjes dhe i ka përshkruar veprimet e tij. Së dyti, i dëmtuari në dëshmitë e tij, ka qenë konsistent gjatë përshkrimit të fakteve kryesore që lidhen me rrethanat e çështjes dhe s'kemi vërejtje ndonjë ndryshim në dëshmitë e tij. Në të gjitha dëshmitë e tij, ka pohuar se ditën e ngjarjes i akuzuari e kishte sulmuar dhe goditur me kosë dhe atë mbrapa shpinës gjersa i njëjti ka qenë i kërrusur mbi prindin e tij i cili kishte mbetur i vrarë në vendin e ngjarjes. Për më tepër, për faktet kryesore dëshmitë e tij përputhen me provat materiale, siç janë: raportet policore, foto-dokumentacionin e vendit të ngjarjes, akt ekspertimi mjeko-ligjor dhe me dëshminë e dëshmitarëve që janë dëgjuar në shqyrtim gjyqësor. Për këtë rast Gjykata ia fali besimin e plotë edhe deklaratës së dëshmitarit E.B. i cili, ka deklaruar se i akuzuari A. ka marrë kosën në vendin e ngjarjes dhe e ka goditur vëllaun e tij R.n mbrapa shpinës. Se i akuzuari ka qenë në vendin e ngjarjes është vërtetuar edhe me deklaratën e dëshmitares A1. Berisha e cila ka qenë prezent ditën kritike dhe ka deklaruar se e ka parë të pandehurin A. duke i rënë vëllain të saj R.t me kos.

- Gjykata i pranon dhe i merr të besueshme dëshmitë e dëshmitarëve B.B. dhe F.B. lidhur me rrethanat që kanë deklaruar, të dy këta dëshmitar kanë dhënë deklaratë menjëherë pas ngjarjes, dhe kanë deklaruar se e kanë parë djalin e Sh.it përkatësisht të akuzuarin A. ditën kritike duke shkuar për në vendin e ngjarjes, deklaratat këto të cilat përputhen në tërësi me deklaratimet e të dëmtuarve dhe deklaratës së dëshmitares A1. B.. Sipas vlerësimit të gjykatës këta dëshmitarë nuk kanë qenë dëshmitar të drejtpërdrejt gjatë zhvillimit të ngjarjes mirëpo, Gjykata i fali besimin sa i përket rrethanave të përgjithshme për të cilat deklaruan si dhe faktit se të njëjtit kanë parë të pandehurin A. ditën kritike, deklaratat këto të cilave Gjykata i fali besimin për arsye se të njëjtit e kanë pasur fqinjë të akuzuarin dhe lehtë e kanë identifikuar.

Gjykata i mori të besueshme provat materiale të cilat janë administruar dhe janë marrë për bazë në këtë rast. Gjykata ia ka fal besimin dëshmisë - akt ekspertimit të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe mendimit të ekspertit mjekoligjor, për sa i përket gjetjeve dhe përfundimeve rreth llojit, natyrës, shkallës dhe rrezikshmërisë së lëndimeve trupore që ka pësuar i dëmtuari në këtë rast R.B.. Sipas vlerësimit të gjykatës, mendimi dhe konstatimi i ekspertëve përputhet plotësisht me provat materiale dhe personale për të dëmtuarin, e që të njëjtat për Gjykatën janë të besueshëm edhe për faktin se janë mbështetur dhe bazuar në ekzaminimin e të dëmtuarit.

- Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit A.H., se i njëjti gjatë shqyrtimit gjyqësor është mbrojtur në heshtje, mirëpo i njëjti në fazat e mëhershme për këtë rast gjatë marrjes në pyetje para gjyqtarit hetues me datën 07.08.2002, kishte deklaruar se sa i përket kësaj ngjarje se si ka ardhur deri te kjo nuk e di pasi sipas tij ditën kritike ka qenë te tezja e tij në fshatin .. në lagjen e, dhe sipas tij aty ka qëndruar deri në orën 18:00 dhe për të shkuar në shtëpinë e tij duhet të kaloj pranë shtëpisë së familjes Berisha dhe sipas tij duke kaluar andej ka parë një grumbull njerëzish duke qëndruar para shitores dhe sipas tij aty ka parë S..... dhe Xh..... me sa i kujtohet dhe se kur ka arritur para shtëpisë së Xh.B..... ka dëgjuar disa të shtëna me armë zjarri të cilat kanë qenë njëra pas tjetrës pothuajse menjëherë. Sipas tij kur ka arritur te shtëpia e ka parë veturën të parkuar në afërsi të stacionit lokal të autobusëve dhe sipas tij pastaj e ka parë vëllaun e tij Xh.n së bashku me axhën e tij I.... duke e sjell babën e tij Sh.in për krahësh, dhe sipas tij kur i ka parë ka vrapsuar në drejtim të tyre dhe pastaj Xh. i ka thënë ta marr veturën dhe së bashku me ta kanë shkuar në Vushtrri te dajhtë e tij ku ka ardhur F.B. kirurg nga Vushtrria. Sipas tij ditën kritike ka qenë te tezja e tij dhe veshur ka pasur kompletin e trenerkave ngjyrë të kaltër të qel, dhe se sipas tij ka qenë prezent kur mjeku kirurg e ka kontrolluar prindin e tij.

Sipas vlerësimit të gjykatës, mbrojtja e tij është tërësisht e pa besueshme dhe ka për qëllim që t'i shmanget përgjegjësisë penale për këtë rast. Mbrojtja e tij nuk gjen mbështetje me asnjë provë të vetëm të rastit. Të gjitha dëshmitë kanë treguar se i akuzuari A. ka qenë prezent ditën kritike dhe se ka ndërmarr veprime në drejtim të vrasjes së të dëmtuarit R.B. e cila vepër ka mbetur në tentativë.

- Gjykata në përshkrimin faktik si në pikën –II- të aktgjykimit nuk ka ndryshuar përmbajtjen esenciale të akuzës në raport me kohën, vendin, të dëmtuarin, të akuzuarin, përveç se ka ndryshuar gjendjen faktike, sipas veprimeve që janë vërtetuar për të akuzuarin në këtë rast. Gjendja faktike është ndryshuar ashtu siç është vërtetuar me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor. Gjendja faktike e përshkruar në aktgjykim në raport me veprimet e të akuzuarit, përputhet me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor andaj, Gjykata sipas detyrës zyrtare e në bazë të akt ekspertizës mjeko ligjore me Nr.ref.07/2003, lëshuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore me datë 17.03.2003, si dhe nga mendimi

dhe konstatimi profesional i ekspertit mjekoligjor Dr.Flamur Blakaj me nr. ref.08/2003 i datës 20.03.2003, është konstatuar se tek ky i dëmtuar, lëndimet i ka pësuar në pjesën e shpinës duke i shkaktuar plagë prerëse nga veprimi mekanik i mjetit prerës, ashtu që bëri plotësimin e saj në masën e lejuar dhe nga këto arsye dhe rrethana, ka ndryshuar duke plotësuar përshkrimin faktik të veprës penale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi ndërsa, lidhur me këtë janë dhënë arsye të mjaftueshme për secilin fakt të vërtetuar.

- Matja dhe caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit -

- Lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin A.H., Gjykata ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 41 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Si rrethana rënduese janë vlerësuar shkalla e lartë e dashjes së shprehur nga i akuzuari, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e tij të plotë, kontributin esencial të vepra penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërinë e saj, gjithashtu si rezultat i veprimit të tij është rrezikuar drejtpërdrejtë jeta e të dëmtuarit të cilit edhe i janë shkaktuar lëndime trupore. Ndërsa, si rrethana lehtësuese janë vlerësuar dhe marrë për bazë, fakti se i akuzuari ka treguar sjellje të mira dhe korrekte në gjykatë, më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, ndaj tij nuk është zhvilluar asnjë procedurë tjetër penale, dhe se ka kaluar një kohë e gjatë nga kryerja e kësaj vepra penale për më shumë se njëzet e gjashtë (26) vite.

Të gjitha rrethanat si më lart, janë posaçërisht lehtësuese e të cilat tregojnë se edhe me një dënim më të butë për të pandehurin mund të arrihet qëllimi i dënimit. Për më shumë, në këtë rast ligji e parasheh mundësinë e zbutjes së dënimit nën minimum e paraparë ligjor, pasi vepra penale ka mbetur në tentativë. Andaj, në përputhje me nenin 42 dhe 43 të LPJ-së, për veprën penale vrasje në tentativë, ndaj të akuzuarit është aplikuar zbutja e dënimit nën minimumin e paraparë ligjor, meqë vepra penale ka mbetur në tentativë. Krejt në fund, vlerësojmë se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është adekuat dhe në përputhje me të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të peshuara në këtë rast. Duke qenë të bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të akuzuarit, por edhe personave tjerë dhe duke besuar që dënimet do të shërbejnë jo vetëm ndaj të akuzuarit, por si masë e preventivës së përgjithshme.

- Llogaritja e paraburgimit -

Sipas nenit 50 të LPJ-së, përcaktohet se koha e kaluar në paraburgim si dhe çdo periudhë e heqjes nga liria lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, me burgim afatgjatë dhe me dënim me gjobë. Mbi këtë bazë, Gjykata ia ka llogaritur të akuzuarit kohën e kaluar në paraburgim në dënimin me burgim të shqiptuar ndaj tij.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike –

- Sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës penale si në pikën I të aktgjykimit, Gjykata ka vendosur në mbështetje të nenit 453 par.1 të KPP-së dhe të njëjtat të paguhen nga mjetet buxhetore të Gjykatës. Ndërsa, vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor si në pikën II të aktgjykimit, Gjykata e mori duke u bazuar në nenet 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 451 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimi për taksën në kompensimin e viktimave të krimit e mori në bazë të nenit 36 par.3, nënpar. 3.2 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Në bazë të nenit 462 par.1 dhe 2 të KPP-së, palët e dëmtuara janë udhëzuar në kontest të rregullt civil, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.301/2006, datë 14.03.2025.

Zyrtarja ligjore
Atdhetare Bashota-Krasniqi

Kryetari i trupit gjykues - Gjyqtari
Fatos Sejdijaj

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.